

20200180325

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURI DHE SHËNDET GJATË PUNËS

Neni 1

Në Ligjin për siguri dhe shëndet gjatë punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 92/2007, 136/11, 23/13, 25/13, 137/13, 164/13, 158/14, 15/15, 129/15, 192/15 dhe 30/16), neni 48-a ndryshohet si vijon:

"(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori i punës përcakton se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka kryer kundërvajtje të përcaktuara në nenet 56, 57 dhe 58 të këtij ligji përveç për rastet e përcaktuara në nenin 49 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, është i detyruar për kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal, në pajtim me ligj dhe me aktvendim të subjektit të mbikëqyrjes inspektuese t'i shqiptojë masën inspektuese vërejtje dhe t'i caktojë afat në të cilin është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë e përcaktuara.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni, miratohet menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh nga dita e përpilimit të procesverbalit, në pajtim me ligj.

(3) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese janë përcaktuar parregullsi dhe shkelje tjera të ligjit ose rregullës tjetër ose parregullsitë e përcaktuara janë mënjanojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori i punës e ndërpret procedurën, me konstatim në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të theksuar në procesverbal, në pajtim me ligj.

(5) Në rastin nga paragrafi (4) i këtij neni, inspektori është i detyruar menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese, në pajtim me ligjin.

(6) Kundër aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (5) të këtij neni, mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit, te organi kompetent për vendimmarrje në shkallë të dytë, në pajtim me ligj.

(7) Ankesa nuk e prolongon realizimin e aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (5) të këtij neni.

(8) Për vërejtjet e shqiptuara nga paragrafi (1) i këtij neni, organi inspektues kompetent mban evidencë, në mënyrë të përcaktuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës."

Neni 2

Në nenin 52 paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

"Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër aktvendimit të komisionit kundërvajtës nga paragrafi (1) i këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje."

Neni 3

Në nenin 53 paragrafi (3) shlyhet.

Paragrafët (4), (5), (6), (7) dhe (8) bëhen paragrafë (3), (4), (5), (6) dhe (7).

Neni 4

Titulli i nenit 54 dhe neni 54 ndryshohen si vijojnë:

"Barazimi

Neni 54

(1) Inspektori i punës për kundërvajtjet nga nenet 56, 57 dhe 58 të këtij ligji, para se të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, është i detyruar kryerësit të kundërvajtjes t'i lëshojë urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e lëshimit të urdhërpagesës kundërvajtëse, do të paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, ndërsa nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar zyrtar do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

(3) Nëse punëdhënësi e përsëritë kundërvajtjen nga nenet 56, 57 dhe 58 të këtij ligji në afat prej një viti nga dita e kryerjes së kundërvajtjes, inspektori i punës me aktvendim do ta ndalojë punën te punëdhënësi në lokalitë e punës, përkatësisht hapësirën e punës, në kohëzgjatje prej 15 ditësh, nëse për kundërvajtjen paraprakisht ka miratuar aktvendim në pajtim me nenin 49 paragrafi (1) i këtij ligji dhe do të parashtojë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, në pajtim me ligjin.

(4) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse e përcakton ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(5) Ankesa kundër aktvendimit të inspektorit të punës nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk e prolongon realizimin e aktvendimit.“

Neni 5

Në nenin 54-a në paragrafin (4) fjalët: “dhe mandatpagesë” shlyhen.

Neni 6

Neni 56 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël – person juridik, gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit të mesëm – person juridik, gjobë në shumë prej 400 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit të madh – person juridik, nëse:

- nuk u mundëson të punësuarve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesit të vet të marrin pjesë në përcaktimin e mangësive dhe në përmirësimin e kushteve për punë, si dhe nuk konsultohet dhe bashkëpunon me të punësuarit dhe kryetarin e organizatës së sindikatës, përkatësisht përfaqësuesin sindikal të sindikatës reprezentative, ose përfaqësuesin e të punësuarve atje ku nuk ka sindikatë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për siguri dhe shëndet gjatë punës, për rreziqet dhe pasojat të cilat dalin gjatë zgjedhjes së pajisjes së punës (neni 13),

- sigurimin e masave për siguri dhe shëndet gjatë punës, si dhe shkatërrimin i shëndetit të të punësuarve i vendos si obligim financiar të të punësuarve (neni 16),

- nuk lidh marrëveshje të nevojshme me shërbime të jashtme për shërbime të veçanta nga sfera e sigurisë dhe shëndetit gjatë punës (neni 24 paragrafi (7)),

- nëpërmjet njoftimeve me shkrim nuk i informon të punësuarit për realizimin e sigurt të punës (neni 25 paragrafët (1) dhe (2)),

- i vendos në përgjegjësi të punësuarit të cilët janë larguar nga vendi i punës për shkak të rrezikut të krijuar serioz dhe të pashmangshëm (neni 25 paragrafi (4)),

- nuk i informon të punësuarit dhe kryetarin e organizatës së sindikatës përkatësisht përfaqësuesin sindikal të sindikatës reprezentative, ose përfaqësuesin e të punësuarve atje ku nuk ka sindikatë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për siguri dhe shëndet gjatë punës, të punësuar për kohësisht si dhe të punësuarve te punëdhënësi tjetër në bazë të marrëveshjes për punë, për çdo rrezik në vendin e punës, si dhe për masat e sigurimit për eliminimin të pasojave të dëmshme (neni 26 paragrafët (1) dhe (2)),

- nuk i lejon të punësuarit dhe kryetarin e organizatës së sindikatës përkatësisht përfaqësuesin e sindikal të sindikatës reprezentative, ose përfaqësuesin e të punësuarve atje ku nuk ka sindikatë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për siguri dhe shëndet gjatë punës të marrin pjesë në diskutime për të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin gjatë punës (neni 27 paragrafi (1)),

- të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre nuk ua prezanton deklaratën për siguri (neni 27 paragrafi (2)),

- përfaqësuesit nuk i mundëson kryerjen e papenguar të funksionit të tij (neni 30 paragrafi (2)) dhe

- nuk mban evidencë për punët e përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 150 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2), dhe (3) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton komisioni kundërvajtës, të cilin e formon ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(5) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër aktvendimit të komisionit kundërvajtës nga paragrafi (4) i këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.“

Neni 7

Neni 57 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël – person juridik, gjobë në shumë prej 600 deri 800 euro punëdhënësit të mesëm – person juridik, gjobë në shumë prej 800 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit të madh – person juridik, nëse:

- nuk emëron një apo më shumë persona përgjegjës për siguri gjatë punës në mjedisin e vet të punës (neni 17 alineja 1),

- nuk angazhon institucion shëndetësor të autorizuar për kryerjen e detyrave profesionale për shëndet gjatë punës (neni 17 alineja 2),

- nuk miraton masa të sigurisë kundër zjarrit sipas rregullave të veçanta (neni 17 alineja 3),

- nuk miraton masa për ndihmën e parë dhe evakuim për rast rreziku (neni 17 alineja 4),

- nuk e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për punët e inspeksionit për punë për fillim me kryerjen e veprimtarisë, tetë ditë para fillimit me të njëjtin (neni 23 paragrafi (1)),

- para fillimit me punët e ndërtimit me shkrim nuk e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për inspeksionin e punës për vendin ku do të realizohen punët (neni 23 paragrafi (2)),

- nuk përcakton plan për evakuim dhe shpëtim për situatat e jashtëzakonshme (neni 24 paragrafi (4)) dhe

- hulumtimet nga neni 34 i këtij ligji nuk janë realizuar në afat prej një viti nga dita e fillimit të objektit me punë, përkatësisht pas secilit ndryshim të procesit teknologjik, rikonstruktimit të objektit, rikonstruktimit të instalimeve teknike ose gjatë ndryshimit të pajisjes teknologjike (neni 35).

(2) Gjobë në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 350 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 450 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Gjobë në shumë prej 30 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet të punësuarit, nëse nuk i respekton masat e përcaktuara për shfrytëzim të drejtë të mjeteve për punë dhe i përjashton, ndryshon ose mënjanon mjetet mbrojtëse të pajisjes dhe nuk e shfrytëzon pajisjen e përcaktuar për mbrojtje personale, nuk e kthen në vendin adekuat dhe nuk bën kontrolle shëndetësore në pajtim me këtë ligj (neni 41 paragrafët (1) dhe (2)).

(5) Për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni kompetent është komisioni kundërvajtës, i formuar nga ministri kompetent për punët nga sfera e punës.

(6) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër vendimit të komisionit kundërvajtës nga paragrafi (5) i këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.“.

Neni 8

Në nenin 57-a në paragrafin (1) numri “5.000” zëvendësohet me fjalët: “2.000 deri 2.500”.

Në paragrafin (2) fjalët: “2.000 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “400 deri 500”.

Në paragrafin (3) numri “5.000” zëvendësohet me fjalët: “2.000 deri 2.500”.

Në paragrafin (4) numri „10.000” zëvendësohet me fjalët: “3.000 deri 5.000”.

Në paragrafin (5) fjalët „2.000 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “400 deri 500”.

Në paragrafin (6) fjalët: „100 deri 200 euro zëvendësohen me fjalët: “50 deri 150”.

Në paragrafin (7) fjalët: „500 deri 700 euro” zëvendësohen me fjalët: “200 deri 250”.

Në paragrafin (8) fjalët: „2.000 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “400 deri 500”.

Pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9), si vijon:

"(9) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.“.

Neni 9

Neni 57-b shlyhet.

Neni 10

Neni 58 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjorbë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël-person juridik, gjorbë në shumë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit të mesëm – person juridik dhe gjorbë në shumë prej 3.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh - person juridik, nëse:

- nuk përpilon dhe nuk zbaton deklaratë për siguri në formë të shkruar ose ajo nuk është përpiluar sipas rregullës nga neni 11 i këtij ligji (neni 11 paragrafët (1) dhe (4)),

- ka lejuar qasje personave të punësuar në vende të punës të cilat janë ekspozuar në rreziqe serioze dhe specifike, ndërsa nuk kanë marrë udhëzime të veçanta për punë (neni 14),

- nuk siguron trajnim për të punësuarit për realizimin e sigurt të punëve (neni 31),

- nuk siguron pajisje për mbrojtje personale për të punësuarit, si dhe përdorimin e saj (neni 17 alineja 6),

- nuk kryen kontrole dhe hulumtime të përkohshme të mjedisit dhe pajisjes së punës (neni 17 alineja 7),

- nuk kryen kontrole shëndetësore të të punësuarve (neni 22 paragrafi (1)),

- nuk kryen kontrole shëndetësore të punësuarve në pajtim me nenin 22 paragrafin (2),

- nuk organizon dhe siguron dhënien e ndihmës së parë të punësuarve në rast të lëndimit gjatë punës (neni 24 paragrafi (5)),

- secilit të punësuar nuk i siguron trajnim adekuat për siguri dhe shëndet gjatë punës nëpërmjet trajnimit teorik dhe praktik, për rast të punësimit, transferimit në vend të ri të punës, vendosjen e teknologjisë së re ose mjeteve për punës si dhe gjatë ndryshimit të procesit të punës (neni 31 paragrafi (1)),

- mjetet për punë nuk i mban në gjendje të mirë nëpërmjet kontroleve dhe hulumtimeve të përkohshme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton, përkatësisht sipas udhëzimeve të prodhuesit, rregullave dhe standardeve teknike (neni 33 paragrafi (1)),

- vendos në përdorim pajisje për punë e cila nuk është testuar për punë të sigurt (neni 33 paragrafi (3)),

- nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit për punë dhe në afat të caktuar nuk i mënjanon parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara (neni 49 paragrafi 3),

- në hapësirat e punës dhe hapësirat ndihmëse nuk bën testimin e dëmeve kimike, biologjike, fizike, mikroklimës dhe ndriçimit (neni 34),

- në afat prej 48 orësh nuk e njofton organin e administratës shtetërore kompetent për punët e inspeksionit të punës dhe kryetarin e organizatës së sindikatës, përkatësisht përfaqësuesin sindikal të sindikatës reprezentative ose përfaqësuesin e të punësuarve dhe përfaqësuesin për çdo rast vdekje, fatkeqësi kolektive dhe lëndime gjatë punës të cilat shkaktojnë paaftësi të përkohshme kohore për punë më shumë se tri ditë pune, si dhe për çdo dukuri e cila paraqet rrezik të drejtpërdrejtë dhe e rrezikon sigurinë e të punësuarve gjatë punës (neni 36 paragrafi (1)),

- nuk i njofton studentët me masat për siguri dhe shëndet gjatë punës para fillimit me punë praktike në miniera (neni 42-a paragrafi (2)),

- realizon punë praktike pa deklaratë të nënshkruar nga studentët se janë njohur me masat për siguri dhe shëndet gjatë punës (neni 42-b paragrafi (1)) dhe

- nuk siguron pajisje për mbrojtje personale për studentët dhe trajnim për shfrytëzimin e të njëjtës (neni 42-b paragrafi (2)).

(2) Gjobë në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik të punëdhënësi mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm dhe gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit – person fizik.

(4) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, nëse:

- nuk i siguron dëshmitë në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 17-e paragrafi (4)) dhe

- nuk vendos sipas kërkesës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 17-e paragrafi (6)).

(5) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar nga organi kompetent publik nga i cili janë kërkuar dëshmitë dhe të dhënat nëse nuk i dorëzon dëshmitë dhe të dhënat e kërkuara në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës (neni 17-e paragrafi (5)).

(6) Për kundërvajtjet e përcaktuara me nenin 58 të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 11

Neni 59 shlyhet.

Neni 12

Në tërë tekstin e Ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 13

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për siguri dhe shëndet gjatë punës.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.